



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR

Peshkopi, më 29.04.2025

ANALIZA

E PUNËS SË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM DIBËR PËR VITIN 2024.

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	Fq.3
1. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I GJYKATËS.....	Fq.4
2. VOLUMI I PUNËS, CILËSIA DHE SHPEJTËSIA E GJYKIMIT	Fq.7
3. PËR NGRITJEN PROFESIONALE TË TRUPËS GJYQËSORE DHE PERSONELIT ADMINISTRATIVE..	Fq.23
4. ADMINISTRIMI I GJYKATËS DHE FUNKSIONIMI I PERSONELIT NDIHMËS (SEKRETARË GJYQËSORE, ARSHIVË, FINANCË, PUNONJËS IT-E)	Fq.24
4.1 ZYRA E KANCELARIT TË GJYKATËS.....	Fq.24
4.2 ZYRA E KRYESEKRATARISË.....	Fq.25
4.3 SEKTORI I BUXHETIT DHE FINANCËS E GJYKATËS.....	Fq.26
4.4 SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN DHE E IT-SË.....	Fq.28
4.5 SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE, SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE DHE PROKURIMIT.....	Fq.30
4.6 SEKTORI PROTOKOLL/ARKIVË DHE KOORDINIMIT TË ZYRAVE TË SHËRBIMIT.....	Fq.32
5. DISA KONKLUZIONE DHE KONSIDERATA PËRFUNDIMTARE.....	Fq.33

HYRJE

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, në veprimtarinë e saj gjatë vitit 2024, është orientuar në dhënien e drejtësisë duke zgjidhur drejtë dhe në kohë të arsyeshme çështjet gjyqësore që i janë paraqitur. Qëllimi kryesor ka qenë garantimi i një procesi të rregullt ligjor, si e drejtë themelore dhe detyrim kushtetues si dhe rritja e besimit të publikut në dhënien e drejtësisë, nëpërmjet sigurimit të aksesit në gjykatë dhe përfitimit të informacionit të plotë e të shpejtë nga ana e qytetarëve. Qëllimi i analizës vjetore¹ është evidentimi i arritjeve dhe problematikave të hasura, adresimi i tyre në funksion të përmirësimit të veprimtarisë së gjykatës gjatë vitit kalendarik 2024, marrja e masave për zgjidhjen e tyre si dhe vlerësimi i punës së kryer në drejtim të arritjes së objektivave dhe përmirësimit të vazhdueshëm të administrimit gjyqësor.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, në këtë analizë vjetore të punës për vitin 2024, paraqet në mënyrë statistikore, gjithë treguesit e punës së saj, vështirësitë që ka hasur, dhe rrugët që kanë bërë të mundur eliminimin e tyre dhe arritjet falë dhe kontributit të vazhdueshëm të gjithë trupës gjyqësore të Gjykatës dhe administratës gjyqësore, kjo me qëllimin e vetëm për të përmbushur “Misionin e dhënies së drejtësisë dhe rritjen e besimit tek publiku”. Gjithashtu, në brendësi të saj gjenden tabela dhe grafikë përsa i përket çështjeve të paraqitura në gjykatë, kohëzgjatjes, statistikave mbi ankimet, cilësia në gjykim, statistikat për çështjes civile dhe statistikat për çështje penale, paraqitje dhe analizë e treguesve statistikorë në vite, si dhe krahasimi me vitet e tjera.

Raporti i analizës është konceptuar në dy pjesë: ku në pjesën e parë do të gjeni të pasqyruar në formë tabelash rezultatet e shërbimit gjyqësor në gjykatë, me të gjithë komponentët; volum, shpejtësi gjykimi dhe cilësi, si dhe një vështrim krahasues me vitin paraardhës, ndërsa në pjesën e dytë të tij, do të gjeni të paraqitur një përshkrim të përgjithshëm të veprimtarisë së institucionit tonë, sa i përket organizimit të brendshëm dhe marrëdhënieve me të tretët.

Pra, në mënyrë të detajuar analiza e punës njëvjeçare, është rezultat i aplikimit të metodologjisë sasiore dhe cilësore duke u bazuar në disa tregues të saj si:

1. Volumi i Punës.
2. Cilësia në gjykimin e çështjeve penale dhe civile.
3. Shpejtësia në gjykim
4. Për ngritjen profesionale të trupës gjyqësore dhe personelit administrative.
5. Administrimi i gjykatës dhe funksionimi i personelit ndihmës (sekretarë gjyqësore, arshivë, financë, punonjës IT-e).
6. Marrëdhëniet institucionale me Prokurorinë, Drejtorinë Vendore të Policisë së Qarkut Dibër, Avokatinë dhe IEVP-Burrel.
7. Disa objektiva që duhet të arrihen në të ardhmen.

¹Bërja e analizës vjetore të gjykatës është detyrim që buron nga interpretimi i nenit 29 të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, që diskutohet në Mbledhjen e Përgjithshme të Gjyqtarëve.

1. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I GJYKATËS

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Diber ka ushtruar veprimtarinë saj për vitin 2024 me këtë strukturë organike:

STRUKTURA ORGANIZATIVE PER GJYKATEN E SHKALLES SE PARE TE JURIDIKSIONIT TE PERGJITHSHEM DIBER viti 2024

Nr.	Funksioni	Numri organik	Kategoria e pages
1	Kryetar		
2	ZV/Kryetar	1	
3	Gjyqtarë	6	
4	Kancelar	1	III-a III-1
5	Kryesekretar	1	III-b IV-1
6	Sekretar gjyqësorë	7	IV-a IV-2
7	Sektori i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar		
8	Shef Sektori	1	III-b IV-1
9	Specialist	1	IV-a IV-2
10	Magaznier	1	
11	Sektori i Burimeve Njerezore, Sherbimeve Mbeshtetese dhe Prokurimeve		
12	Shef Sektori	1	III-b IV-1
13	Specialist	1	IV-a IV-2
14	Sanitar	1	
15	Shofer	1	
16	Punonjës sigurie	2	
17	Ftues	2	
18	Sektori i IT, Statistike dhe Marredhenive me Publikun dhe Median		
19	Shef Sektori	1	III-b IV-1
20	Specialist	1	IV-a IV-2
21	Sektori i Koordinimit te Zyrave te Sherbimeve dhe Protokoll/Arkive		
22	Shef Sektori	1	III-b IV-1
23	Specialist Protokoll/Arkive - zyra shërbimit Mat	3	IV-a IV-2
	TOTALI	33	

1.1 Veprimtaria Gjyqësore.

Sa i përket numrit të gjyqtarëve, gjatë vitit 2024, ka pasur lëvizje në trupën gjyqësore. Në muajin Prill 2024, gjyqtare Suela Lika është transferuar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Në muajin Korrik 2024, gjyqtari Xhevdet Lika është transferuar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Dhe, në muajin Shtator 2024, gjyqtari Artan Çupi është transferuar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Trupa gjyqësore është plotësuar në muajin Tetor 2024, me caktimin nga Këshilli i Lartë Gjyqësor të magistratëve të sapoemëruara, gjyqtarës Megi Anxhela Muhaj, gjyqtarës Flutura Çuko dhe gjyqtarës Arxheina Shkopi pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

Organizimi i punës së trupës gjyqësore është bërë pa u ndarë në seksione, për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve në organikë, kjo e kushtëzuar edhe me faktin e garantimit të parimit të barazisë së shpërndarjes së njëllotje të punës tek secili anëtar i trupës gjyqësore si dhe duke pasur në konsideratë ngarkesën e punës të përcaktuar në aktet e KLGJ-së, ku për kryetarin (zëvendëskryetarin) është 75 % e ngarkesës dhe për gjyqtarët është 100% e ngarkesës. Theksojmë këtu se ndarja e çështjeve në Gjykatë, është bërë mbi bazën e shortit elektronik dhe urdhërave të lëshuara nga zv.Kryetari i Gjykatës, për procedurat e shortit, ku çështjet e depozituara në Kryesekretari janë shpërndarë tek anëtarët e trupës gjyqësore çdo ditë. Gjithashtu edhe rindarja e çështjeve me short dhe plotësimi i trupave gjyqësore është bërë nëpërmjet shortit elektronik bazur në vendimin me Nr.554 datë 29.12.2022 "Për organizimin dhe ndarjen me short të çështjeve gjyqësore" dhe Vendimin 724 datë 07.12.2023, " Për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore" të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Numri i sallave të gjykimit pranë kësaj gjykate janë pesë nga ku vetëm katër prej tyre janë funksionale, sepse salla e krijuar për gjykimin e çështjeve penale me të mitur është përdorur si zyrë arkivi, në kushtet e mospasjes së ambienteve të tjera të lira për arshivim. Nga katër sallat në dispozicion të gjyqtarëve, vetëm salla me nr.1 është e përshtatshme për zhvillimin e gjykimeve penale me pjesëmarrje të personave të ndaluar, arrestuar apo dënuar. Gjatë këtij viti, të gjitha seancat gjyqësore efektive, janë regjistruar në procesverbale audio, duke u zhvilluar gjykimet në salla, përveç atyre që ligjet përkatëse procedurale kërkojnë që të zhvillohen në dhomë këshillimi.

Në mungesë të kryetarit, kompetencat e tij janë ushtruar nga Zv. Kryetari i Gjykatës.

Këshilli i Gjykatës ka zhvilluar rregullisht mbledhjet mujore. Për shkak të mungesës së Kryetarit të Gjykatës, si anëtar zëvendësues ka vepruar gjyqtari përkatës vijues me numrin më të madh të votave në listën e gjyqtarëve të votuar për zëvendëskryetar të gjykatës. Gjithashtu, për shkak se Kancelarja e Gjykatës ka munguar për arsye se ka qenë me leje barrëllindje deri më datë 08.11.2024, është zëvendësuar deri për atë kohë nga një nëpunës civil i nivelit të lartë i KLGJ, i caktuar nga KLGJ.

Këshilli i Gjykatës ka trajtuar problematikat dhe marrë vendimet përkatëse, ku spikasin zhvillimi i procedurave të rekrutimit dhe marrjes në punë për tre punonjës në pozicionin sekretar gjyqësor, një punonjës në pozicionin specialist financë, dy punonjës në pozicionin specialist arkivi, një punonjës në pozicion specialist statistike dhe një punonjës specialist prokurimi me lëvizje paralele. Ka trajtuar dhe marrë vendime lidhur me veprimtarinë financiare të gjykatës si miratimi i projektbuxhetit afatmesëm dhe miratimin e formularit të ankesës.

Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve. Në zbatim të nenit 29 të ligjit për 98/2016, "Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve të gjykatës

është thirrur rregullisht nga zëvendëskryetari i cili ushtron edhe detyrat e kryetarit. Gjithashtu mbledhjet janë zhvilluar me regjistrim audio në sallën nr. 1, për shkak së në sallën e mbledhjeve është vendosur dokumentacion arkivor pasi në Gjykatë ka mungësë ambienti për arkiv. Në mbledhjen e përgjithshme të gjyqtarëve janë diskutuar raportet e ILD-së: “Mbi kryerjen e inspektimit tematik të gjykatave dhe zyrave të prokurorive pranë tyre mbi trajtimin e kërkesave me objekt lirim me kusht”. “ Mbi ndarjen e çështjeve me short”, ”kontrollin e raportimeve të sistemit elektronik në gjykatë”, “ Mbi ndarjen e çështjeve me short, si edhe kontrollin e raportimeve të sistemit elektronik në gjykatë”. Në mbledhjen e përgjithshme të gjyqtarëve janë diskutuar projektregullore apo projektligje të sjellë nga KLGj-ja për mendim. Gjithashtu, nga trupa gjyqësore janë diskutuar praktika gjyqësore të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese apo praktika që kanë secili gjyqtar për çështje specifike.

1.2 Veprimtaria e administratës gjyqësore.

Kancelarja ka qenë me leje barrë lindje deri më datë 08.11.2024. Rezulton se deri me datën 08.11.2024, kur është paraqitur në punë znj. Shpresa Cenaj (Kancelarja), detyra e kancelares është ushtruar nga z. Leonard Tusha_nëpunës civil gjyqësor, në lidhje me aktivitetin e përditshëm të gjykatës, duke përjashtuar ato detyra që lidhen me ushtrimin e të drejtës së votës. Caktimi i Z.Leonard Tusha është bërë me vendim të Këshillit të Gjykatës së datës 09.06.2023.

Nga zyra e Kancelarit të Gjykatës është bërë përpjekje e rëndësishme për përmirësimin e punës administrative të Gjykatës, të rregullshmërisë të të gjitha veprimeve që kryhen nga ana e saj, si dhe përballimit të gjithë kërkesave që qytetarët kanë në lidhje me shërbimin gjyqësor që përballohet nga kjo zyrë. Nga ana e kancelarit është bashkepunuar me cdo sektor për mbarevajtjen e punës në gjykatë nga ku rezulton se ka patur një bashkepunim të frytshëm.

Gjatë vitit 2024 struktura organike sa i përket administratës gjyqësore ka qenë e paplotë fillimisht dhe është plotësuar në pjesën më të madhe gjatë vitit 2024. Kështu sipas sektorëve rezulton:

- a. Në strukturën e Shërbimeve Gjyqësore, për vitin 2024, ka patur 4 vende vakante sekretare gjyqësore. 2 vende sekretare gjyqësore janë plotësuar më datë 01.03.2024. 1 vend sekretare gjyqësore është plotësuar më datë 23.12.2024. Procedura për rekrutimin e 1 sekretare gjyqësore ka vazhduar në vitin 2025.
- b. Sektori i Buxhetit ka qenë i paplotësuar për shkak të zgjatjes së procedurës së rekrutimit. Ky sektor është plotësuar me datë 23.10.2024, kur ka filluar detyrën specialisti i financës.
- c. Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve, është plotësuar me levizje paralele në pozicionin e specialistit të prokurimeve më datë 01.03.2024.
- d. Sektorin e TI-së, Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun është plotësuar me datë 01.03.2024, kur ka filluar detyrën specialisti i statistikës.
- e. Në sektorin e Protokollit dhe Arkivit për vitin 2024, është larguar me dorëheqje nëpunësi civil gjyqësor me detyrë arkivist me datën 02.07.2024, dhe ky sektor është plotësuar me dy punonjës me detyrë arkivist me datë 23.10.2024.

Në Projekt-Buxhetin Afatmesëm për vitet 2025-2027, të miratuar nga Këshilli i Gjykatës në Mars 2024 i është kërkuar Këshillit të Lartë Gjyqësor për shtesë të strukturës organike në pozicione të cilat janë imediate dhe ndikojnë drejtpërdrejtë në veprimtarinë e kësaj gjykate si më poshtë:

Në sektorin e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar

a. 1(një) vend për specialist buxheti.

Në sektorin e Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve

a. Specialist i burimeve njerëzore 1(një) vend.

b. Mirëmbajtës 1(një) vend.

c. Sanitare 1 (një) vend).

Në sektorin e TI-së, Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun

a. Specialist TI 1(një) vend.

Në sektorin e Protokollit dhe Arkivit.

a. Specialist arkivi me kontratë me afat të përkohshëm 1(një) vend.

Në strukturën e Shërbimeve Gjyqësore.

a. Sekretare gjyqësore për regjistrim 1(një) vend.

2. VOLUMI I PUNËS, CILËSIA DHE SHPEJTËSIA E GJYKIMIT

Për periudhën 01 Janar 2024 deri në 31 Dhjetor 2024 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër janë shqyrtuar në total 2072 çështje nga të cilat 513 të mbartura nga viti 2023 dhe 2165 të regjistruara të reja për vitin 2024. Nga këto, janë gjykuar (përfunduar gjykimi) në total 2072 çështje nga të cilat 1356 me lëndë penale ku përfshihen çështje penale në fazën e hetimeve paraprake, në seancë paraprake, themeli, kërkesa në fazën e ekzekutimit dhe 716 me lëndë civile ku përfshihen të gjitha çështjet të cilat shqyrtohet sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile dhe ligjeve të tjera të posaçme.

Tabela 1: Volumi i çështjeve.

Volumi i çështjeve viti 2024	Numri
Çështje të gjykuara	2072
Çështje të mbartura nga viti 2023	513
Çështje të regjistruara të reja në vitin 2024	2165

Tabela 2: Tendencat e ngarkesës në vite.

Viti	Çështje të regjistruara	Çështje të gjykuara	Çështje të mbartura
2022 (DI+MT)	2359	2350	468
2023 (DI+MT)	2227	2182	513
2024	2165	2072	606

Norma e zgjidhjes/likuidimit të çështjeve.

Nëpërmjet normës së zgjidhjes së çështjeve përcaktohet aftësia në tërësi e gjykatës për zgjidhjen e çështjeve gjyqësore, nëpërmjet raportit të çështjeve të zgjidhura me çështjet e regjistruara për periudhën konkrete. Norma e zgjidhjes/likuidimit të çështjeve “Clearance rate”, (që është raporti i thjeshtë i dalë nga pjestimi ndërmjet çështjeve të zgjidhura me çështjet e reja të regjistruara brenda një periudhe vjetore, i shprehur në përqindje), në vitin 2024 është 95.70 %.

$$CR = \frac{(2072) \text{ numri i çështjeve të gjykuara}}{(2165) \text{ numri i çështjeve të reja}} * 100 = 95.70 \%$$

2.1 Çështjet penale.

Në vitin 2024, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër janë regjistruar 1449 çështje të reja penale dhe janë gjykuar në total 1356 çështje penale. Për të gjitha çështjet e natyrës penale për vitin 2024 norma e përfundimit/likuidimit të çështjeve “Clearance rate” është 93.58%

$$CR_{penale} = \frac{(1356) \text{ numri i çështjeve të gjykuara}}{(1449) \text{ numri i çështjeve të reja}} * 100 = 93.58\%$$

Tabela 3: Çështjet Penale të gjykuara.

Natyra e çështjeve	Numri i çështjeve në vitin 2023	Numri i çështjeve në vitin 2024
Penale themeli	289	304
Kërkesa penale	1090	1052
Total	1379	1356

Gjatë vitit 2024 rezulton se kanë përfunduar 1052 kërkesa penale. Nga të cilat, kërkesa në fazën e hetimit paraprak janë shqyrtuar 216 çështje ku 107 prej tyre janë me objekt “Vleftësimin dhe caktimin e masës së sigurimit” dhe 109 janë kërkesa të tjera në fazën e hetimit paraprake; 56 çështje me objekt “Dërgimin e çështjes në gjyq” (ku në 37 çështje është vendosur pranim kërkesë , 3 prej tyre është vendosur kthim aktesh dhe 16 prej tyre është vendosur pushimi i çështjes) dhe 583 kërkesa me objekt “Pushimin e procedimit penal” (ku në 552 çështje është vendosur pranim kërkesë dhe në 31 prej tyre është vendosur kthim aktesh), 22 kërkesa me objekt “Ankim ndaj vendimit të mosfillimit të prokurorit”, 4 kërkesa me objekt “Ankim ndaj vendimit të pushimit të prokurorit” ku janë vendosur në 3 raste mospranimin e kërkesës dhe 1 rast pranim kërkesë dhe 171 kërkesa në fazën e ekzekutimit.

2.1.1 Çështjet penale të themelit.

Tabela 4: Çështjet penale të themelit

Natyra e çështjeve	Numri i çështjeve në vitin 2024
Gjykimi i Zakonshëm	54
Gjykimi i Drejtpërdrejtë	21
Gjykimi i Shkurtuar	217
Miratim Urdhri Penal	4
Gjykimi me Marrëveshje	8
Totali	304

Gjatë vitit 2024 kanë përfunduar 304 çështje penale themeli nga të cilat 54 çështje janë shqyrtuar me gjykim të zakonshëm, 21 çështje janë shqyrtuar me gjykim të drejtpërdrejtë, 217 çështje janë shqyrtuar me gjykim të shkurtuar, 4 kërkesa për miratimin e Urdhrit Penal janë shqyrtuar në dhomë këshillimi dhe 8 çështje janë shqyrtuar në gjykim me marrëveshje. Nga analiza e të dhënave të vitit 2024 rezulton se çështjet janë gjykuar kryesisht duke aplikuar gjykimin e shkurtuar, përveç atyre në të cilat të pandehurit janë gjykuar në mungesë. Një numër shumë i vogël, gati i pakonsiderueshëm është ai i çështjeve në të cilat gjykimi i zakonshëm është kërkuar nga vetë të pandehurit. Po ashtu, për vitin 2024 konstatohet se në disa raste është aplikuar gjykimi i drejtpërdrejtë, kryesisht në veprat penale “Drejtimi automjetin në mënyrë të parregullt” dhe “Dhuna në familje”. Ndërkohë në numër të vogël, gati të pakonsiderueshëm kanë qenë rastet kur janë aplikuar lloje të tjera të gjykimeve të posaçme si “Urdhëri penal” dhe “Marrëveshja për pranimin e fajësisë”.

Tabela 5: Veprat penale të shqyrtuara në çështje penale themeli.

Nr. Rendor	Figura e veprës penale	Neni	Numri i rasteve në vitin 2023	Numri i rasteve në vitin 2024
1.	Vrasje me dashje	Neni 76	0	4
2.	Vrasje me paramendim	Neni 78	2	1
3.	Kanosja	Neni 84	0	1
4.	Vrasja nga pakujdesia	Neni 85	0	1
5.	Plagosje e rëndë me dashje	Neni 88	1	1
6.	Plagosje e lehtë me dashje	Neni 89	2	4
7.	Dëmtime të tjera me dashje	Neni 90	7	2
8.	Vepra të turpshme	Neni 108	1	0
9.	Shtrengimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë	Neni 109/b	0	1

10.	Dhunimi i banesës	Neni 112	1	2
11.	Pornografia	Neni 117/2,3	0	1
12.	Shpifja	Neni 120	1	0
13.	Ndërhyrje të padrejta në jetën private	Neni 121	0	2
14.	Përndjekja	Neni 121/a	1	2
15.	Mosdhënia e mjeteve për jetesë	Neni 125	1	0
16.	Marrja e padrejtë e fëmijës	Neni 127	1	2
17.	Dhuna në familje	Neni 130/a,1,2,3,4	35	33
18.	Vjedhja	Neni 134	7	14
19.	Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike	Neni 137	8	0
20.	Vjedhja me dhunë	Neni 139	1	1
21.	Vjedhja me armë	Neni 140	1	0
22.	Mashtrimi në sigurime	Neni 145	1	14
23.	Shkatërrim i pronës	Neni 150	2	5
24.	Shkatërrimi i pronës me zjarr	Neni 151	2	0
25.	Ushtrimi pa licencë i veprimtarive financiare	Neni 170/ç	0	1
26.	Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë	Neni 172	1	1
27.	Kontrabanda me mallra të tjera	Neni 174	3	0
28.	Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë	Neni 178	0	1
29.	Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë	Neni 179/a	0	1
30.	Mospagimi i taksave dhe tatimeve	Neni 181	1	0
31.	Falsifikimi i dokumentave	Neni 186	1	2
32.	Falsifikimi i letërnjoftimeve, pasaportave ose vulave	Neni 189	1	2
33.	Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve	Neni 190	1	1

34.	Organizimi ose ushtrimi i veprimtarive të lojërave të fatit në kundërshtim me ligjin	Neni 197	0	11
35.	Vënia në dispozicion e lokaleve për lojëra të palejuara	Neni 198	0	1
36.	Ndërtimi i paligjshëm	Neni 199/a/1, 2,3	27	26
37.	Peshkimi i ndaluar	Neni 204	1	0
38.	Prerja e paligjshme e pyjeve	Neni 205	2	2
39.	Kundërshtimi i punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik	Neni 235/2	1	0
40.	Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik	Neni 236/2	4	3
41.	Goditjet për shkak të detyrës	Neni 237	1	5
42.	Mosbindje ndaj urdhërit të punonjësit të policisë së rendit publik	Neni 242	2	1
43.	Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike	Neni 244	1	1
44.	Shpërdorimi i detyrës	Neni 248	4	3
45.	Prishja e qetësisë publike	Neni 274	1	2
46.	Vetëgjyqësia	Neni 277	1	3
47.	Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit	Neni 278	13	15
48.	Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta	Neni 279	2	6
49.	Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive	Neni 280	0	1
50.	Prodhim dhe shitja e narkotikëve	Neni 283	7	19
51.	Kultivim i narkotikëve	Neni 284	8	3
52.	Përvetësimi i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale	Neni 287/b	1	0
53.	Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë	Neni 289	3	2
54.	Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	Neni 290	6	9
55.	Drejtimi i automjetit në mënyrë të parregullt	Neni 291	74	77
56.	Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror	Neni 297	29	15
57.	Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve	Neni 298	1	1
58.	Moskallëzimi i krimit	Neni 300	2	0

59.	Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës	Neni 301	0	1
60.	Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës	Neni 320	0	1
61.	Kallëzimi i rremë	Neni 305	3	0
62.	Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës	Neni 321	0	1
63.	Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit	Neni 323	7	5

Sipas të dhënave të mësipërme statistikore rezulton se kriminaliteti në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër karakterizohet nga një larmishmëri veprash penale duke përfshirë si veprat penale me rrezikshmëri të ulët shoqërore ashtu edhe ato me rrezikshmëri të lartë. Veprat penale më të përhapura në vitin 2024 janë veprat penale “Drejtimet automatike në mënyrë të parregullt”, “Dhuna në familje”, ndjekur nga “Ndërtimi i paligjshëm” dhe “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”.

Vepra penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” mbetet vepra penale me raste më të shumta të shqyrtimit, njësoj si për vitin 2023.

Rëndësi të veçantë, për vetë natyrën e saj, paraqet vepra penale “Dhuna në familje”, me 33 raste të tilla. Nga këto të dhëna, konstatohet se fenomeni i dhunës në familje vazhdon të mbetet shqetësues. Rezulton se viktimat e dhunës në familje në të shumtën e rasteve kërkojnë urdhër të menjëhershëm mbrojtje/urdhër mbrojtje më tepër sesa ndjekjen penalisht të autorit, çka do të thotë se numri i rasteve të ndjekjes penale për këto vepra në fakt pasyqron një numër më të vogël nga realiteti. Në këtë aspekt, është e domosdoshme marrja e masave shtesë nga institucionet përkatëse për përmirësimin e situatës dhe me qëllim final pakësimin sa më tepër të numrit të viktimave të dhunës.

Vepra penale “Ndërtimi i paligjshëm” mbetet përafërsisht në të njëjtar numër raste.

Ndërsa, për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, vihet re një rritje e rasteve në krahasim me vitin e kaluar dhe për këtë shkak institucionet shtetërore duhet të rrisin nivelin e kontrollit me qëllim parandalimi e tyre.

Rezulton se për vitin 2024, janë shqyrtuar me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtar 14 çështje penale themeli që parashikojnë dënim penal në maksimum mbi 10 vite burgim.

Tabela 6: Vendimmarja e Gjykatës.

Të dënuar	Për vitin 2023	Për vitin 2024
Totali të dënuar	316	280
Totali pafajësi	1	11
Pushuar	6	23

Në lidhje me vendimmarrjen e gjykatës në çështjet e natyrës penale themeli, rezulton se janë dënuar në total 281 persona, nga të cilët 5 femra dhe 276 meshkuj. Për 11 persona gjykata ka dhënë vendim pafajësie, ndërsa për 22 persona gjykata ka vendosur pushimin e çështjes penale. Nga krahasimi i të dhënave të vitit 2024 me vitin parardhës, evidentohet fakti se kemi një numër më të vogël të dënuarish. Po ashtu, konstatohet se janë dhënë më shumë vendime pafajësie dhe pushimi në vitin 2024.

Tabela 7: Llojet e dënimeve të dhëna.

Lloji i dënimit	Për vitin 2023	Për vitin 2024
Me gjobë	44	20
Burgim deri në 2 vjet	61	44
Burgim nga 2 deri në 5 vjet	16	14
Burgim nga 5 deri në 10 vjet	1	5
Burgim nga 10 deri në 25 vjet	-	3
Burgim i përjetshëm	-	-
TOTAL	122	86

Nga krahasimi i të dhënave të vitit 2024 me vitin parardhës evidentohet një rënie dënimeve me gjobë dhe atyre me burgim deri në dy vjet, kjo në proporcion edhe me llojin e veprave penale. Ndërkohë kemi një numër më të madh dënimesh me burgim nga 5 deri në 10 vjet burgim apo 10 deri në 25 vjet burgim, çka tregon në mënyrë indirekte edhe rritjen e kësaj kategorie veprash penale.

Tabela 8: Dënimet alternative.

Lloji i dënimit	Për vitin 2023	Për vitin 2024
Gjysëm liria(neni 58 i Kodit Penal)	-	-
Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë (neni 59 i K.Penal)	182	164
Punë në interes publik (neni 63 i K.Penal)	12	30
TOTAL	194	194

Për shkak dhe të nivelit të ulët të rrezikshmërisë së veprave penale numri i dënimeve alternative është i konsiderueshëm dhe dënimi alternativ më i aplikuar është ai i pezullimit të dënimit me burgim

dhe vënien në provë, i ndjekur nga kryerja e një pune me interes publik. Për vitin 2024, rezulton që nuk është aplikuar dënimi alternativ i gjysmëlirisë.

2.1.2 Kërkesat Penale.

Gjatë vitit 2024 janë gjykuar 1052 çështje të natyrës kërkesa penale, ku përfshihen kërkesat në fazën e hetimeve paraprake, kërkesat për pushim dhe dërgim në gjyq nga Gjyqtari i Seancës Paraprake dhe kërkesat në fazën e ekzekutimit.

Tabela 9: Kërkesat penale të gjykuara

Natyra e çështjeve	Numri i çështjeve në vitin 2024
Kërkesa në fazën e hetimeve paraprake	216
Kërkesa me objekt “Dërgim i çështjes në gjyq”	56
Kërkesa me objekt pushimi i procedimit penal.	583
Kërkesa me objekt “Ankim ndaj vendimit të mosfillimit të prokurorit	22
Kërkesa me objekt “Ankim ndaj vendimit të pushimit të prokurorit	4
Kërkesa në fazën e ekzekutimit	171
Total	1052

Tabela 10: Masat e sigurimit personal.

Lloji i masës së sigurimit personal	Për vitin 2023	Për vitin 2024
Arresti në burg	98	38
Arresti në shtëpi	33	29
Detyrim për t’u paraqitur	40	34
Shtrimi i përkohshëm	4	8
Ndalimi i daljes jashtë shtetit	-	-
Vendosje nën mbikëqyrje të prindërit (Ligji Nr. 37/2017)	-	-
Pezullim nga detyra	-	-
TOTALI	145	109

Nga të dhënat statistikore të parastruara më lart mund të konkludojnë që në vitin 2024, krahasuar me vitin 2023, ka pasur një rënie të kërkesave për vleftësimin e arrestit/ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit personal. Gjithashtu, duhet të sqarojmë se ka një mospërputhje midis numrit të kërkesave

të shqyrtuara dhe numrit të masave të sigurimit personal të caktuara, kjo për shkak se në një kërkesë mund të ishin disa persona të arrestuar apo të ndaluar.

Nga treguesit e mësipërm rezulton se masat e sigurimit më të aplikuara nga gjykata kanë qenë “Arresti me burg”, ndjekur nga “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe “Arresti në shtëpi”. Masat e parashikuara nga neni 238, 237 dhe 234 të Kodit të Procedurës Penale kanë pësuar një rënie për vitin 2024, krahasuar me viin paraardhës, kjo për shkak të rënie të kërkesave për vleftësimin e arrestit/ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit personal.

Po ashtu, nga të dhënat statistikore evidenohej një rritje e numrit të masave “Shtrim në spital psikiatrik”, për shkak të gjendjes mendore të personave nën hetim nga 4 rast i vetëm në vitin 2023, në 8 raste për vitin 2024.

Tabela 11. Kërkesat në fazën e ekzekutimit

Natyra e çështjeve	Numri i çështjeve në vitin 2024
Parashkrimi i ekzekutimit të dënimit me burgim	1
Bashkim dënimesh	7
Revokim pezullim të vendimi me burgim	7
Lirimi me kusht	18
Lejim Ekstradimi	1
Njohje vendimi të huaj	2
Të drejtat e të dënuarve me burgim (ulje dënimi, kundërshtim mase disiplinore, ndryshim sigurie burgu, transferim, etj)	72
Shuarje dënimi	15
Kërkesa të tjera	48
Total	171

2.2 Çështje civile

Për vitin 2024 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër janë gjykuar gjithësej 716 çështje civile, nga të cilat 482 civile themeli me palë kundërshtare dhe 234 kërkesa të natyrës civile.

Për të gjitha çështjet civile për vitin 2024 norma e përfundimit/likuidimit të çështjeve “Clearance rate” është 100%.

$$CR_{civile} = \frac{(716)\text{numri i çështjeve të gjykuara}}{(716)\text{numri i çështjeve të reja}} * 100 = 100\%$$

Shqetësim mbeten çështjet civile të kthjera me të meta, për shkak të mosplotësimit në kohë nga palët ndërgjyqëse të të metave të kërkesës/kërkesëpadisë, sidomos përsa i përket formës së akteve provuese dhe pagimit të taksës gjyqësore. Në lidhje me çështjet e pushuara, shkak kryesor mbetet mosparaqitja e paditësit/kërkuesit dhe tërheqja nga gjykimi i padisë/kërkesës, ndërsa rastet e padisë që nuk mund të ngrihet janë të pakta.

Në zbatim të vendimit të KLGJ-së Nr. 554 , datë 29.12.2022 “Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore”, çështjet e pushuara apo të kthjera me të meta kur janë riparuar për shqyrtim në gjykatë i kanë kaluar automatikisht të njëjtit gjyqtar që ka vendosur më parë.

2.2.1 Çështje civile themeli (me palë kundërshtare)

Tabela 12: Çështje civile (me palë kundërshtare)

Lloji i çështjes	Për vitin 2023	Për vitin 2024
Padi pronësie	40	26
Padi pjestim sendi	3	4
Kundërshtimi i veprimeve përmbartimore	8	5
Marrëdhënie pune	17	21
Zgjidhje martesë	269	283
Padi Familjare të tjera	42	71
UM/UMM	56	60
Padi posedimore	-	2
Padi begatim pa shkak	-	1
Padi te kontrateve te shitjes	-	1
Padi kontrate sipërmarrje	-	1
Padi kontrate e sigurimit	-	1
Padi te tjera kontraktuale	-	4
Çështje tregtare te tjera	-	2
TOTALI	435	482

Nga të dhënat statistikore më lart rezulton se për vitin 2024 ngarkesën më të madhe të çështjeve civile e përbëjnë mosmarrëveshjet familjare, si ato me objekt “zgjdhje martese”, padi të tjera të parashikuara nga Kodi i Familjes dhe kërkesepadi për lëshimin e Urdhrave të Menjëhershëm të Mbrojtjes/Urdhër Mbrojtje.

2.2.2 Kërkesa civile

Tabela 13: Kërkesat civile.

Lloji i çështjes	Për vitin 2023	Për vitin 2024
Vërtetim fakti juridik	48	46
Urdhëra ekzekutimi	183	104
Kërkesa për lëshim autorizimi (për të miturin)	9	11
Kërkesa Civile të tjera (ndihmë juridike dytësore, ndreqje gabimi, përjashtim trupi gjykues, etj)	72	73
TOTALI	312	234

2.3 Shpejtësia në gjykimin e çështjeve civile dhe penale

Tabela 14: Kohëzgjatja e gjykimeve penale

Afati/Çështje penale	< 6 muaj	Në %	6-12 muaj	Në %	1-2 vjet	Në %	> 2 vite	Në %	TOTALI
Viti 2023	1316	96%	15	1%	32	2%	4	0%	1367
Viti 2024	1290	95%	51	4%	14	1%	1	0%	1356

Afati/Çështje penale	< 6 muaj	Në %	6-12 muaj	Në %	1-2 vjet	Në %	> 2 vite	Në %	Nr. seancave gjyqësore	Nr. seancave per ceshtje	TOTALI Çështjeve	
Viti 2024	Krime	210	90%	18	8%	4	2%	1	0%	1270	6	233
	Kundravajtje Penale	54	75%	13	19%	4	6%	0	0%	258	4	71
	Kërkesat penale	1026	98%	20	2%	6	1%	0	0%	20243	2	1052

Tabela 15: Kohëzgjatja e gjykimeve civile

Afati /çështje civile	< 6 muaj	Në %	6-12 muaj	Në %	1-2 vjet	Në %	> 2 vite	Në %	TOTALI
Viti 2023	744	91%	53	7%	11	1%	7	1%	815
Vitit 2024	569	79%	118	16%	28	4%	1	0%	716

Afati/Çështje Civile		< 6 muaj	Në %	6-12 muaj	Në %	1-2 vjet	Në %	> 2 vite	Në %	Nr. seancave gjyqësore	Nr. seancave per çështje	TOTALI Çështjeve
Viti 2024	Civile Themeli (përveç çështjeve familjare)	38	43%	33	37%	18	20%	0	0%	482	1	89
	Familjare	320	81%	67	17%	6	2%	0	0%	1285	3	393
	Kërkesa Civile	211	90%	18	8%	4	2%	1	0%	499	2	234

Koha e nevojshme për përfundimin/likujdimin e çështjeve (Case Disposition Time), civile dhe penale, për vitin 2024 është 107 ditë. Për çështjet civile koha nevojshme për përfundimin/likujdimin e çështjeve është 145 ditë, ndërsa për çështjet penale është 86 ditë.

$$DT = \frac{(606) \text{ numri i çështjeve të pagjykuara}}{(2072) \text{ numri i çështjeve të gjykuara}} * 365 = 107 \text{ ditë}$$

Për të gjitha çështjet e natyrës civile në vitin 2024 koha përfundimit/likujdimin të çështjeve “Case Disposition Time” është 145 ditë.

$$DT_{civile} = \frac{(285) \text{ numri i çështjeve të pagjykuara}}{(716) \text{ numri i çështjeve të gjykuara}} * 365 = 145 \text{ ditë}$$

Për të gjitha çështjet e natyrës penale në vitin 2024 koha përfundimit/likujdimit të çështjeve “Case Disposition Time” është 86 ditë.

$$DT_{\text{penale}} = \frac{(321) \text{ numri i çështjeve të pagjykuara}}{(1356) \text{ numri i çështjeve të gjykuara}} * 365 = 86 \text{ ditë}$$

Nga sa më lart, rezulton se koha e nevojshme për përfundimin e çështjeve penale në tërësi është më e ulët se ajo për çështjet civile dhe për këtë ndikojnë rregulat e Kodit të Procedurës Civile. (për shkak se disa çështje civile janë të pezulluar deri në përfundimin e një çështje tjetër penale apo civile duke sjell që çështja e pezulluar të qëndrojë për një kohë relativisht të gjatë pa u shqyrtuar).

Në vitin 2024 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër kanë ushtruar detyrën 10 gjyqtarë ku tre gjyqtarë janë transferuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër në Gjykata të tjera. Po gjatë këtij viti, KLGJ ka emëruar tre gjyqtarë të ri në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, ku aktualisht është organikë e plotë e trupës gjyqësore.

Tabela 16: Kohëzgjatja e gjykimeve në ditë për secilin gjyqtar për vitin 2024.

Gjyqtari	Çështje të pagjykuara	Çështje të gjykuara	Koha e përfundimit në ditë
Artan Çupi	1	247	82
Arxheina Shkopi	72	40	31
Enkeleda Halilaj	99	352	62
Flutura Çuko	88	36	28
Megi Anxhela Muhaj	83	27	26
Mevlute Çausi	95	343	73
Orald Hoxha	77	342	55
Romeo Merruko	90	373	58
Suela Lika	0	96	106
Xhevdet Lika	0	216	80
Aurel Arapi	1	0	-

Tabela 17: Çështje për secilin gjyqtar.


Gjyqtari	Çështje të mbartura nga viti 2023	Çështje të reja të regjistruara nga data 01.01.2024	Çështje të gjykuara	Çështje në shqyrtim gjyqësor për vitin 2025
Artan Çupi	66	182	247	1
Arxheina Shkopi	10	102	40	72
Enkeleda Halilaj	88	363	352	99
Flutura Çuko	20	104	36	88
Megi Anxhela Muhaj	16	94	27	83
Mevlute Çausi	55	383	343	95
Orald Hoxha	57	362	342	77
Romeo Merruko	65	398	373	90
Suela Lika	54	42	96	0
Xhevdet Lika	81	135	216	0
Aurel Arapi	1	0	0	1
TOTAL	513	2165	2072	606

Shpërndarja e ngarkesës ndërmjet gjyqtarëve është pothuajse e barabartë në numër çështjesh (duke mos patur parasysh kompleksitetin e çështjeve). Në disa raste diferenca lidhet me shqyrtimin e një numri të lartë kërkesash të hetimeve paraprake për procedim penal, nga gjyqtari i hetimeve paraprake apo në mosbalancën e çështjeve të themelit me kërkesat penale dhe civile. Nga të dhënat statistikore rezulton se ngarkesa e çdo gjyqtari me çështje është në një nivel mesatar, ngarkesë e cila mund të përballohet në kushtet aktuale, pra me organikën prej 7 gjyqtarësh.

2.4 Aspekte të zhvillimit të procesit të rregullt ligjor dhe etikës gjyqësore

Gjatë vitit 2024 kanë qenë të disponueshme 4 salla gjykimi. Vetëm salla me nr.1 është e përshtatshme për zhvillimin e gjykimeve penale me pjesëmarrje të personave të ndaluar, arrestuar apo dënuar. Për këto shkaqe, infrastruktura e gjykatës përbën shkak për zhvillimin jo në orar të proceseve gjyqësore, për shkak të përplasjeve të orareve ndërmjet gjyqtarëve. Gjatë këtij viti ashtu si edhe në vitet e mëparshme, të gjitha seancat gjyqësore efektive, janë regjistruar në procesverbale audio, duke u zhvilluar gjykimet në salla, përveç atyre që ligjet përkatëse procedurale kërkojnë që të zhvillohen në dhomë këshillimi (për lejinim e përgjimeve dhe gjykime të tjera me karakter sekret). Referuar të dhënave të përpunuara nga PAKS, rezulton se gjatë vitit 2024, rreth 96.28% e seancave janë regjistruar audio, duke u zhvilluar në total 5620 seanca, ndërsa vetëm 217 seanca, që përbëjnë rreth 3.72 %, nuk janë regjistruar audio. Për

më tepër, shih grafikun më poshtë ku tregohet përdorimi i sistemit RDAV (regjistrimi dixhital audio-video). Duhet pasur parasysh se numri sallave të gjykimit pranë kësaj gjykate janë pesë nga ku vetem 4 prej tyre janë funksionale, ndërsa salla e krijuar për gjykimin e çështjeve penale me të mitur nuk është funksionale pasi aktualisht po përdoret si zyrë arkivi, një problem që duhet adresuar dhe mundësia e dhënies zgjidhje për vitin në vazhdim.



Kemi një numër të vogël të seancave që nuk janë regjistruar audio, për ato çështje të cilat Kodi lejon shqyrtimin në dhomë këshillimi pa pjesëmarrjen e palëve. Nuk janë evidentuar problematika në respektimin e afateve ligjore, për sa i përket vënies në lëvizje të dosjeve të marra, kryerjes së veprimeve paraprake/përgatitore, edhe sa i takon arsyetimit të vendimeve. Për vitin 2025 synohet sa i përket dorëzimit të vendimeve në sekretarinë e gjykatës të minimizohet dhe të mos jetë më shqetësim as për trupën gjyqësore dhe sidomos për përdoruesit e gjykatës. Nuk janë evidentuar problematika në lidhje me fillimin e seancave me vonesë, për shkaqe ta pajustificuara. Për sa i përket seancave të filluar me vonesë për shkaqe të justifikuara ndodh pasi zgjaten tej afateve të planifikuara të seancave paraardhëse si dhe për shkak se në Gjykatë është vetëm një sallë penale ku për shkak të ngarkesës ndonjëherë sjell fillim me vonesë të seancave gjyqësore.

Nga zëvendëskryetari i Gjykatës nuk është kryer asnjë referim për masë disiplinore, si pasojë e shkeljes së etikës dhe solemnitetit nga ana e trupës gjyqësore. Gjithashtu rezulton se nuk janë paraqitur ankesa për gjyqtarët tek zëvendëskryetari i Gjykatës.

2.5 Kontrolli gjyqësor nga gjykatat më të larta

Sipas të dhënave statistikore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Diber rezulton se ndaj vendimeve gjyqësore të dhëna nga trupa gjyqësore e kësaj gjykate, pra ndaj 300

vendimeve civile janë ushtruar. Pjesa me e madhe e vendimeve të ankimuara nuk janë shqyrtuar nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Tabela 18: Vendimmarja e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Gjyqtari	Çështje të ankimuara	Mënyra e zgjidhjes së çështjes civile/penale/familjare etj... nga Gjykata e Apelit Tiranë:						
		Lëni en në fuqi të vendimit	Ndryshim in plotësisht të vendimit	Ndryshimi n pjesërisht të vendimit	Prishjen e vendimit dhe pushimi n e gjykimit	Prishjen e vendimit dhe kthimin për rigjykim	Mospranimin e ankimit	S'ka përgjigje
Artan Çupi	34	4	0	0	0	0	2	28
Arxheina Shkopi	4		0	0	0	0	0	4
Enkeleda Halilaj	44	9	0	1	0	0	0	34
Flutura Çuko	2	0	0	0	0	0	0	2
Megi Anxhela Muhaj	2	0	0	0	0	0	0	2
Mevlute Çausi	50	2	0	0	0	0	0	48
Orald Hoxha	55	5	0	1	0	0	0	49
Romeo Merruko	57	7	2	0	0	0	1	47
Suela Lika	37	3	0	1	0	0	0	33
Xhevdet Lika	52	10	0	0	0	0	3	39
GJITHËSEJ	337	40	2	3	-	-	6	286

Veç tabelës së mësipërme ka dhe ankime ndaj vendimeve të ndërmjetëme, por që nuk janë pasqyruar në tabelë. Siç shihet, shqyrtimi i ankimeve për çështjet nga Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm të Apelit janë vetëm për 51 çështje, dhe kjo ka ardhur për shkak të mungesës së gjyqtarëve dhe ndikimit që ka pasur reforma në drejtësi. Pjesa me e madhe e vendimeve të shqyrtuara nga Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm të Apelit janë lënë në fuqi.

2.6 Kërkesat për heqje dorë nga gjykimi i çështjeve dhe përjashtimi i gjyqtarit nga shqyrtimi gjyqësor

Tabela 19: Kërkesat për heqje dorë

	Viti 2024	Pranim	Mospranim
Kërkesë për heqje dorë	27	25	2
Kërkesa për përjashtim	8	0	8

Nga analizat e të dhënave rezulton se për vitin 2024 janë paraqitur në total 27 kërkesa për heqje dorë nga gjyqtarët e kësaj gjykate dhe për 25 (njëzet e pesë) kërkesa është vendosur pranimi i tyre, ndërsa për 2 (dy) kërkesa është vendosur mospranimi. Shkaqet e heqjes dorë nga gjykimi i çështjeve lidhen me pjesëmarrjen e gjyqtarëve në procese të tjera gjyqësore të lidhura apo vendimarrje të mëparshme ku janë shprehur me vlerësime nga të cilat cenohet paanësia; ekzistenca në marrëdhënie kredie ose konflikt gjyqësor me palët ndërgjyqëse dhe parashikimit në ligj të mosshqyrtimit të një çështje nga gjyqtari që më parë ka gjykuar një çështje tjetër të caktuar. Nuk rezulton si shkak për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes ekzistenca e arsyeve të tjera serioze të njëanshmërisë.

Ndërkohë për vitin 2024 rezulton se kemi edhe kërkesa për përjashtim të trupës gjyqësore, kërkesa këto të paraqitura nga palët pjesëmarrëse në gjykim. Rezulton se nga 8 (tetë) kërkesa të paraqitura për përjashtim gjyqtari është disponuar me mospranim kërkesë. Shkaqet kryesore të rrëzimit të kërkesës për përjashtim janë: paraqitja nga pala kërkuese si shkak përjashtimi vendimarrja e ndërmjetme e gjyqtarit, mosparaqitja e arsyeve të njëanshmërisë nga ato të parashikuara në ligj, dhe mosdepozitimi i akteve për të provuar ekzistencën e arsyeve të njëanshmërisë.

3. PËR NGRITJEN PROFESIONALE TË TRUPËS GJYQËSORE DHE PERSONELIT ADMINISTRATIV.

Edhe gjatë vitit 2024, në këtë drejtim janë bërë përpjekje për ngritjen e aftësisë profesionale të trupës gjyqësore, kjo e parë në dy drejtime:

a-në frekuentimin e temave, që ka trajtuar Shkolla e Magjistraturës, dhe në

b-punimin e vendimeve gjyqësore që kanë cënuar gjykatat më të lartë, ndaj vendimeve të marra nga trupa gjyqësore e kësaj gjykate nga viti 2024 e në vazhdim.

c-diskutimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Strasburgut në Mbledhjet e Përgjithshme të Gjyqtarëve pranë kësaj Gjykate.

Kështu, në të gjitha takimet mujore me trupën gjyqësore janë zhvilluar diskutime për çështje të natyrës juridike dhe rrahje mendimesh, në lidhje me unifikimin e praktikës gjyqësore, jo vetëm për problemet që trajtojnë në vetvete vendimet unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, por edhe vendime të tjera që kanë trajtuar tema të tjera me interes dhe që u japin zgjidhje çështjeve konkrete gjyqësore. Diskutimi i këtyre vendimeve ka ndihmuar trupën gjyqësore për një kuptim më të

drejtë të instituteve më të rëndësishme të së drejtës, dhe për të unifikuar një praktikë të njëjtë në veprimtarinë e kësaj gjykate. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim kanë luajtur vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë.

Gjithashtu, këtij qëllimi i kanë shërbyer dhe trajnimet vazhduese që organizon Shkolla e Magjistraturës, që vetë gjyqtarët e kësaj gjykate, kanë bërë përzehjerpër t'u trajnuar, pasi trupa gjyqësore ka ndjekur të gjitha seminarët me përjashtim të ndonjë teme që gjyqtari për të cilën ka bërë planifikim ka qenë në periudhë gaditshmërie dhe ka qenë i pamundur të marrë pjesë.

Sa i përket administratës gjyqësore, janë kryer takime javore e mujore për të diskutuar probleme të veçanta, që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e procesit gjyqësor dhe përdorimin e sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore dhe sistemin audio të seancave gjyqësore.

Kontrollet e vazhdueshme që janë bërë në hedhjen e pasqyrimin e të dhënave të dosjesve gjyqësore apo mbajtjen e përmbledhur të shënimeve të procesverbalet e seancave gjyqësore, kanë bërë që administrata gjyqësore të jetë më e vëmendshme në ndjekjen e procedurave ligjore dhe për rrjedhojë në vënien në efikasitet të etikës dhe solemnitetit të zhvillimit të seancave gjyqësore, të cilat gjithmonë janë mbajtur nën kontrollin dhe mbikqyrjen e trupave gjyqësore.

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR				
<i>Pasqyra e numrit të nëpunësve civilë gjyqësorë të trajnuar, për periudhën 01 Janar - 31 Dhjetor 2024</i>				
Emër Mbiemër	Pozicioni	Numri i trajnimeve nga ASPA	Numri i trajnimeve nga ndërkombëtarët	Numri i trajnimeve të tjera
Elsi Çausi	Shef Sektori IT, Statistikë dhe Mardhënie me Publikun	6	3	2
Suida Shehu	Specialist Statistikash	0	0	2
Jetmira Basha	Shef Sektori, Sektori Burimeve Njerëzore dhe Prokurimeve	6	0	0
Leonard Tusha	Specialist Prokurimesh	3	2	2
Ermira Koçi	Shef Sektori, Sektori Protokoll/Arkivë	1	0	1
Eriol Sula	Specialist Arkivi	0	0	1

4. ADMINISTRIMI I GJYKATËS DHE FUNKSIONIMI I PERSONELIT NDIHMËS (SEKRETARË GJYQËSORE, ARSHIVË, FINANCË, PUNONJËS IT).

4.1 Zyra e Kancelarit të Gjykatës.

Këshilli i Gjykatës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër me vendimin e datës 09.06.2023 ka vendosur: “Caktimin e z. Leonard Tusha, aktualisht me detyrë "Sekretar gjyqësor" pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër për kryerjen e funksionit të Kancelarit deri në kohën kur Kancelarja e emëruar, znj. Shpresa Cenaj, të ketë mundësi të ushtrojë kompetencat e saj”. Rezulton se deri më datë 08.11.2024, kur është paraqitur në punë znj

Shpresa Cenaj, detyra e kancelarit është ushtruar nga z. Leonard Tusha, në lidhje me aktivitetin e përditshëm të gjykatës, duke përjashtuar ato detyra që lidhen me ushtrimin e të drejtës së votës.

Nga zyra e Kancelarit të Gjykatës është bërë përpjekje e rëndësishme për përmirësimin e punës administrative të Gjykatës, të rregullshmërisë të të gjitha veprimeve që kryhen nga ana e saj si dhe përbalimit të gjithë kërkesave që qytetarët kanë në lidhje me shërbimin gjyqësor që përballohet nga kjo zyrë. Nga ana e kancelarit, është bashkëpunuar me çdo sektor për mbarëvajtjen e punës në gjykatë nga ku rezulton se ka patur një bashkëpunim të frytshëm.

Nga ana e Kancelares janë kryer takime javore e mujore me shefat e çdo sektori për të diskutuar probleme të veçanta që kanë të bëjnë me çdo problematikë të çdo sektori, ku janë realizuar objektivat, si dhe janë diskutuar problematika të ndryshme.

Nga ana e çdo sektori, është gjetur mirëkuptimi dhe bashkëpunimi për zgjidhjen në kohë reale të çështjeve që shqetëson gjykatën.

4.2 Zyra e Kryesekretarisë e Gjykatës.

Nga zyra e Kryesekretares të Gjykatës është bërë përpjekje e rëndësishme për përmirësimin e punës si dhe dhënien e shërbimit për përfaqësuesit e institucioneve dhe për publikun.

Sa i përket respektimit të së drejtës së informimit dhe të dhënies së akteve personave të interesuar, ky shërbim është ofruar shpejtë dhe me cilësi nga zyra e kryesekretarisë e Gjykatës në bashkëpunim me zyrën e arkivit të kësaj gjykate. Gjykata pavarësisht sa kemi thënë më sipër, ka arritur një standart të lartë në orientimin e publikut dhe ofrimin e shërbimeve. Shërbimet ofrohen për publikun në çdo orë brenda orarit zyrtar të punës, nga ora 08.⁰⁰-16.⁰⁰.

Seancat gjyqësore shpallen publikisht në kohë reale në një vend të dukshëm në fasadën e gjykatës, ku jepet informacioni i plotë për palët, gjyqtarin e çështjes, sallën e gjykimit dhe orarin e gjykimit si dhe shpallen edhe listat e shortit të çështjeve, pas hedhjes së tyre çdo ditë të javës në orën 15.00. Megjithatë vlen të vihet në dukje në aspektin e respektimit të të drejtës së informimit, gjykatës i mungon një ambjent i posaçëm kontakti për studimin e dosjeve gjyqësore nga palët pjesëmarrëse në gjykim e avokatët e tyre, por për këtë është shfrytëzuar zyra e Kryesekretarisë, ku përfitohen shërbimet gjyqësore.

Shpallja, arsyetimi i vendimeve dhe dorëzimi i tyre në Kryesekretarinë e Gjykatës brenda 30 ditëve çështjet penale dhe brenda 20 ditëve çështjet civile, apo dhe para këtyre afateve, është bërë tashmë praktikë në këtë Gjykatë.

Edhe sekretaria gjyqësore si një aktor i pandarë i trupës gjyqësore dhe i përmbushjes së misionit të “dhënies së drejtësisë”, gjatë vitit 2024, ka përbaluar një volum të madh punë, ku ajo në të gjithë veprimtarinë e saj, ka ndjek me përpikmëri kërkesat që burojnë nga ligji organik, rregullorja e brendshme dhe urdhërat e udhëzimet që ka lëshuar për normimin e aktivitetit Zv.Kryetari i Gjykatës, Këshilli Lartë Gjyqësor dhe Kancelari i Gjykatës.

Sekretaria gjyqësore gjatë vitit 2024, ka përballuar një volum të madh punë ku sekretar gjyqësor efektivë në punë, për pjesën më të madhe të vitit, kanë qenë më pak se struktura organike e saj. Gjykata ka në organikë 7 (shtatë) gjyqtar, ndërsa sekretar gjyqësorë në fillim të vitit kanë qenë efektivisht vetëm 3 (tre), ku një sekretare ka punuar edhe me tre gjyqtarë njëkohësisht.

Gjykata ka filluar procedurat për plotësimin e 2 (dy) pozicioneve të lira në pozicionin e punës "Sekretar Gjyqësor". Për pozicionet e punës "Sekretar/e gjyqësor", kategoria IV-a" procedurat kanë vazhduar edhe vazhdojnë edhe gjatë vitit 2025.

Në muajin Mars 2024 u rekrutuan 2 punojës sekretar gjyqësor Z.Albert Nesimi dhe Znj.Linda Bulku. Në muajin Dhejtor 2024 u rekrutua edhe një sekretar gjyqësor Znj.Emada Domazeti, duke bërë që nr. i sekretarëve gjyqësor të jetë 6.

Gjatë vitit 2025 janë marrë të gjitha masat për plotësimin sa më parë të vendeve vakate në pozicionin e punës "Sekretar Gjyqësor", procedurë e filluar që në vitin 2024.

Ndërkohë në muajin Janar 2025 u rekrutua edhe 1 tjetër sekretar gjyqësor Znj.Ejona Noka. Gjykata ka tashmë 7(shtatë) sekretare gjyqësore.

Nga ana e sekretarëve gjyqësorë janë plotësuar kërkesat e Udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë nr.353, datë 03.09.2013 "*Për përcaktimin e rregullave të hollësishtme për mbajtjen, ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio*" dhe të Udhëzimit të KLGJ-së, të miratuar me Vendimin Nr.353, datë 11.07.2024 "*Për mënyrën e përdorimit të teknologjisë Audio/Audiovizive në procesin gjyqësor*". duke përcaktuar regjistrimin e detyrueshëm të seancave gjyqësore, gjykimit të çështjeve në orarin e caktuar, pa vonesa si dhe shpalljen e listave të gjykimit në vendet e përcaktuara pranë tabelave të gjykatës.

Nga dita e hënë deri ditën e premte pranë kësaj Gjykate janë planifikuar seanca gjyqësore për të cilat gjatë gjithë ditës depozitohen akte të ndryshme si kërkesa për shtyrje, akte për çështjet në gjykim apo printimi i emaileve, të cilat duhet ti dërgohen në moment trupës gjyqësore duke bërë që të ndërpritet cdo lloj pune.

Nga ana e kryesekretares janë bërë disa here kërkesa drejtuar këshillit të Gjykatës për të miratuar punonjës shtesë apo për të caktuar një punonjës për rregjistrimin e kërkesa në rregjistra fizik dhe në sistemin ICMIS por nuk ka qenë e mundur por në fillim të vitit 2025 nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, është bërë e mundur miratimi i një punonjësi shtesë sekretar gjyqësor i cili do të kryejë detyrën e sekretarit rregjistruar pranë zyrës së kryesekretarisë.

4.3 Zyra e Degës së Buxhetit dhe Financës e Gjykatës

Në mbështetje të ligjit nr. 97/2023 "Për Buxhetin e vitit 2024", Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.9, datë 20.03.2018 "*Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit*", Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.22, datë 17.11.2016, "*Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qëndrore, po paraqesim raportin e monitorimit për periudhën Janar – Dhjetor 2024, për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Diber.*

- Raporti i shpenzimeve sipas programeve buxhetore

Buxheti i detajuar në fillim të vitit 2024 ishte 70,169,100 leke. Shpenzime Faktike të Periudhës/Progresive si 12-mujor për këtë program janë 65,039,224 lekë. Plani i periudhes progressive është realizuar 93%.

2 -Raporti mbi Ekzekutimin e Buxhetit në nivelin e Programit të Buxhetit

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik

Shpenzime Faktike të Periudhës/Progresive 12-mujori 2024

600	Paga	52,349,353 leke
601	Sigurime Shoqërore	5,878,396 leke
602	Mallra dhe Shërbime	6,494,435 leke
231	Kapitale te trupezuara	197,040 leke

Totali i Shpenzime Korente 64,842,184 leke

Totali Shpenzime për Investime 197,040 leke

Totali i Shpenzimeve të Programit 65,039,224 leke

Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit (Kap 06) 328,680 lekë

Totali (Korrente + Kapitale + Shpenz.nga te ardh.jashte limit 65,367,904 lekë

Shpenzimet Buxhetore në Total Programi

Buxheti Gjyqësor 2024 Plani fillestar Art. 231 -200,000 leke

Buxheti Gjyqësor 2024 Plani i rishikuar Art. 231 -197,100 leke

Buxheti Gjyqësor 2024 Shpenzime faktike Art. 231-197,040 leke

Ndryshimi ne vlere absolute 60 leke

Realizimi ne % 100

Buxheti Gjyqësor 2024 Plani fillestar Art. 600 - 57,800,000leke

Buxheti Gjyqësor 2024 Plani i rishikuar Art. 600 – 53,000,000leke

Buxheti Gjyqësor 2024 Shpenzime faktike Art. 600- 52,349,353 leke

Ndryshimi ne vlere absolute 650,647 leke

Realizimi ne % 99

Buxheti Gjyqësor 2024 Plani fillestar Art. 601 - 9,000,000 leke
Buxheti Gjyqësor 2024 Plani i rishikuar Art. 601 – 8,852,000 leke
Buxheti Gjyqësor 2024 Shpenzime faktike Art. 601- 5,878,396 leke

Ndryshimi ne vlere absolute 2,973,604 leke
Realizimi ne % 66

Buxheti Gjyqësor 2024 Plani fillestar Art. 602 - 14,000,000 leke
Buxheti Gjyqësor 2024 Plani i rishikuar Art. 602 – 8,000,000leke
Buxheti Gjyqësor 2024 Shpenzime faktike Art. 602- 6,494,435leke

Ndryshimi ne vlere absolute 1,505,565 leke
Realizimi ne % 81

4.4 Sektori IT-së, Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun.

a. Koordinatorit për të Drejtën e Informimit

Qëllimi themelor i Ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, është sigurimi i një publiku të informuar në një kohë sa më të shpejtë dhe një administratë llogaridhënëse. Këto janë jetike për funksionimin e një shoqërie demokratike dhe paraqiten si domosdoshmëri për të sfiduar korrupsionin dhe për të siguruar përgjegjshmërinë e zyrtarëve. Rritja e besueshmërisë së publikut ndaj sistemit gjyqësor në përgjithësi, si dhe përmirësimi i shërbimeve duke rritur sasinë e informacionit publik është qëllim në vetvete i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

Shërbimet e marrëdhënieve me publikun dhe median ushtrohen nga/ose nën mbikëqyrjen e gjyqtarit të caktuar për marrëdhëniet me publikun dhe median znj. Mevlute Çausi si dhe të koordinatorit për të drejtën e informimit Elsi Çausi.

Nëpërmjet zyrës së Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, janë kryer komunikime të vazhdueshme me gazetarët e kronikës dhe të shtypit të shkruar.

Për vitin 2024 rezultojnë të regjistruara gjithsej 6 kërkesa në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, duke specifikuar se janë regjistruar ato kërkesa që kanë ardhur në respektim të nenit 11, të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, me qëllim dhënien e informacionit në kohë sa me reale dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, drejt të gjithë personave të interesuar (kryesisht gazetarë të kronikës) operon dhe me grupin “ëhat’s up”, në të cilin gazetarët adresojnë çështjet për të cilat kërkojnë informacion dhe kanë interes dhe përgjigja i’u kthehet në grup, në mënyrë transmetimin e informacionit në të njëjtën kohë.

Gjithashtu, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, gjatë vitit 2024, organizoi dhe një takim me përfaqësues të medias, ku prezent ishin gazetarë të mediave lokale, gjyqtarja e medias, zëvendës kryetari i gjykatës si dhe koordinatori për të drejtën e informimit, të cilët ndër të

tjera, adresuan edhe problematikat që i shqetësojnë në përditshmërinë e tyre në raport me gjykatën si dhe gjithashtu, u la e hapur mundësia për zgjidhje të këtyre shqetësimeve.

Programi i transparencës është vlerësuar si një mënyrë konkrete përmes së cilës Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ndërton dhe rrit transparencën në punën e saj institucionale, nën garancinë e të drejtës për informim.

Informacioni i bërë publik në seksionin: Programi i Transparencës, por edhe në faqen zyrtare ëeb të Gjykatës, synon transparencën e veprimtarisë së punës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, duke e pasqyruar në rubrika, tekste/përmbajtje, afate kohore për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike, si dhe strukturën përkatëse, e cila prodhon ose administron dokumentin. Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menu-të ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë. Dokumentacioni i bërë publik është i përditësuar në formë e përmbajtje. Faqja zyrtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë, në format lehtësisht të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave, referuar legjislacionit në fuqi.

Gjykata ka kthyer përgjigje në rrugë elektronike dhe ka dhënë orientimet e nevojshme për qytetarët që të mund të drejtohen pa vështirësi në gjykatë për të marrë informacionin e nevojshëm me anë të fletëpalosjeve, formularëve elektronikë apo informacionit që gjendet në faqen zyrtare ëeb të gjykatës, ndërkaq akte të tjera administrative që kanë të bëjnë me procedurat në gjykatë, të cilat kanë karakter të përgjithshëm janë publikuar rregullisht në faqen e internetit të gjykatës.

Publikimi për informim i çdo urdhri të brendshëm të titullarit, si dhe vendimmarrjeve të Këshillit të Gjykatës, me karakter të përgjithshëm të cilat përpilohen në funksion të menaxhimit të punës në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, është kryer nën kujdesin e veçantë të koordinatorit për të drejtën e informimit me qëllim rritjen e transparencës, paanësisë së administratës gjyqësore, aktivitetit të saj, rregullimin e brendshëm si dhe shërbimit ndaj publikut.

Gjykata, si “kontrollues i të dhënave personale”, në respektim të së drejtës së privatësisë, ka vazhduar me mos pasqyrimin e vendimeve të plota gjyqësore në faqen e saj zyrtare ëeb dhe krijimin e një kodi për çdo çështje gjyqësore, e cila mundëson qasjen në to vetëm të palëve ndërgjyqëse, si dhe medias, për çështje gjyqësore me interes publik. Megjithatë vlen të përmendet se mbetet një problem anonimizimi i vendimeve, për shkak të mungesës së personelit administrativ.

Megjithatë, pavarësisht kësaj sfide, Gjykata nëpërmjet koordinatorit për të drejtën e informimit ka synuar të realizojë, për aq sa ka qenë e mundur, respektimin e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale në vendimet gjyqësore që publikohen, si një e drejtë themelore në respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, e sanksionuar në Kushtetutë dhe në një sërë aktesh të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare.

Gjatë vitit 2024 në Gjykata Dibër për here të pare është angazhuar edhe në realizimin dhe zhvillimin e seancave gjyqësore me videokonferencë ndërmjet gjykatës tonë dhe autoriteteve të huaja

b. Zyra e Teknologjisë dhe Informacionit (IT)

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër aplikon sistemin për menaxhimin e çështjeve gjyqësore ICMIS, një sistem që funksionon që nga viti 2007. Ky sistem gjatë viteve është përmirësuar, dhe vazhdon të përmirësohet ku gjatë vitit 2024 është asistuar nga kompania që merret me mirëmbajtjen e këtij sistemi 10 kërkesa për support të kërkuara nga ana jonë, po ashtu gjatë këtij viti janë shtuar si risi zhvillimet:

1. Zhvillimi për rishortimin e çështjeve gjyqësore, duke plotësuar kriterin e transparencës, parimet e rastësisë dhe kushtin e shpërndarjes së peshës sipas kriterëve për secilin gjyqtar.
2. Zhvillimi i cili auditon veprimet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore ICMIS .
3. Zhvillimi i cili mundëson raport auditimi për verifikimin e gjyqtarëve pjesëmarrës në shortimin e çështjeve...

Por, përsëri lindi nevoja për përmirësime thelbësore. Ndryshim tjetër thelbësor gjatë vitit 2024 është ndryshimi total i pajisjeve kompjuter ne sallat e gjyqit duke i zëvendëzuar me kompjutera te viteve te fundit si dhe duke implementuar edhe teknologjite e rregjistrimit dixhital audio video në sallat e gjyqit duke shtuar 8 kamera IP PTZ në sallat e gjyqit si dhe një storage lokal në dhomën e serverit për arkivimin e seancave gjyqësore ne formatin dixhital Audio-Video. Në bashkëpunim me KLGJ dhe me asistencën e tyre u bë e mundur gjatë kësaj periudhe edhe:

- ndryshimi i migrimit mailbox-eve (emailit zyrtar) nga databaza e AKSHI-t në serverin e Këshillit të Lartë Gjyqësor duke krijuar kështu një pavarësi në përdorimin e emailit zyrtar.

-instalimi i softëare i detektimit të sulmeve kibernetike të avancuara, agjentit Trellix.

Gjatë kësaj periudhe është bërë e mundur një asistencë e vazhdueshme e të gjithë njësisë së IT te çdo përdorues i sistemit për t'u siguruar që çdo vështirësi dhe problematikë e shfaqur të zgjidhet në mënyrë të shpejtë dhe efikase.

Pajisjet kompjuterike me të cilat punojnë gjyqtarët dhe stafi i administratës janë prodhim i vitit 2016 deri në vitin 2023 ku marka kompjuterave kryesor janë HP, Dell, Lenovo dhe FUJITSU.

Në gjykatë punohet kryesisht më programin Microsoft Office 2016 , FTR Gold 7.1 (për sallat e gjyqit edhe për sekretaret) dhe sistem Operimi Windows 10, të gjitha këto të licensuar nga KLGJ.

c. Statistikat

Në vitin 2024, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër është caktuar, për herë të parë në organikë dhe në punë një punonjëse specialiste statistikash e dedikuar për grumbullimin, përpunimin dhe raportimin e statistikave të gjykatës, bazuar në çdo kërkesë që vjen pranë saj, kryesisht nga institucione shtetërore, veçanërisht, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Ministria e Drejtësisë dhe Inspektoriat i Lartë i Drejtësisë. Ky funksion që ushtrohet nën mbikqyrjen e Shefit të sektorit dhe kancelarit të Gjykatës, ka lehtësuar disi ngarkesën e kryesekretarisë.

4.5 Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetese dhe Prokurimeve.

Gjatë vitit 2024, struktura e numerit të punonjësve të miratuar është 33 punonjës, te ndarë 7 (shtatë) gjyqtarë dhe 26 –Administratë gjyqësore. Në muajin Janar 2024, struktura në fakt ishte 26 punonjës,

ku vënde të paplotësuar ishin 7 (shtatë) dhe këto nga Administrata Gjyqësore. Procedurat e rekrutimit janë zgjatur për një afat relativisht të gjatë, për disa arsye. Kemi patur ndryshime të herëpashershme të anëtarëve të Këshillit të Gjykatës (2 ndryshime të Zv.kryetarëve, ndryshim të Kancelarit).

1. Vendimi nr. 1, datë 01.08.2024 “Për zgjedhjen e Gjyqtarit Artan Çupi në funksionin e zv. Kryetarit (kjo për faktin e transferimit të Zv.Kryetarit Xhevdet Lika ne Gjykatën Sh.Parë J.P. Durrës)
2. Vendimi nr. 3, datë 30.09.2024 “Për zgjedhjen e Gjyqtarit Romeo Merruko në funksionin e zv. Kryetarit (kjo për faktin e transferimit të Zv.Kryetarit Artan Çupi ne Gjykatën Sh.Parë J.P. Tiranë)
3. Paraqitja në punë e Kancelares Shpresa Cenaj me dt 08.11.2024, pas lejes së lindjes.

Nisur nga ky fakt, në fund të vitit 2024 struktura në plan është 33 punonjës dhe në fakt 32 punonjës. Gjatë hartimit të projekt buxhetit për vitin 2025 që është përgatitur në muajin Mars 2024 dhe i rishikuar kemi kërkuar shtesë të organikës për çdo sektor ku na janë miratuar dhe vazhdon puna për rekrutimin e tyre gjatë vitit 2025.

Gjatë vitit 2024, me fondet të cilat janë alokuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si dhe nga fondet e mbedhura nga 10 % i të ardhurave të realizuara nga shitja e pullave dhe 1 % e kërkesë padive kemi bërë të mundur realizimin e disa procedurave prokurimi për plotësimin e nevojave për vijueshmërinë sa më efikase të punës në Institucionin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, ku në mënyrë të përmbledhur janë realizuar këto prokurime:

Nr	Objekti i prokurimit	Vlera publikur pa tvsh	Vlera e fituar pa tvsh
1	Paisje kundër zjarrit	166666	86200
2	Tavolina	80000	78000
3	Kancelari	625000	387000
4	Materiale Pastrimi	100000	98610
5	Materiale elektrike	100000	94180
6	Materiale hidraulike	100000	70550
7	Pjesë këmbimi	100000	99800
8	Sherbim në mirmbajtje mjete të transporti	100000	98000
9	Shërbim mirmbajtje gjeneratori	100000	76800
10	Sherbim mirmbajtje kaldaje	100000	97500
11	Shërbim dhe mirëmbajtje elektrike	450000	334000
12	Blerje shtypshkrime	708333	129600
13	Blerje Tonera	583333	21248
14	Sherbim mirmbajtje paisje elektronike	100000	99800
15	Shërbim dhe mirëmbajtje godine	100000	98540
16	Siguracion makine	70000	37900
17	Veshje për sanitare, arkiviste e materiale tjera	100000	98000

18	Blerje goma	100000	96000
19	Blerje sherbimi për transportin e mallrave	100000	70000

Nga përdorimi i të ardhurave

Nr	Objekti i prokurimit	Vlera publikur pa tvsh	Vlera e fituar pa tvsh
1	Paisje të tjera –arkivi	180000	178900
2	Paisje zyre elektronike	100000	95000

Gjatë vitit 2024, deri më 08.11.2024, punonjësi Z.Leonard Tusha me detyrë Specialist Prokurimesh ka kryer detyrën e Kancelarit,.

4.6 Sektori Protokoll/Arkivë dhe Kordinimit te Zyrave te Sherbimit.

Sektori Protokoll/Arkivë dhe Koordinimit të zyrave të Shërbimit është krijuar si sektor në vitin 2023 ku në organikë janë një shëf sektori dhe tre punonjës specialist arkivi.

Përsa i përket arkivës në këtë Gjykatë paraqitet një problematikë serioze që ka të bëjë me mungesën e hapsirave të mjaftueshme për arkiv ku në mungesë të tyre po përdoret ambientet si zyrë, sallë mbledhje dhe sallë gjyqi për sisteminin e dokumentacionit arkivor, duke krijuar mungesën e kushteve të nevojshme të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për ruajtjen fizike e teknologjike të dokumenteve. Në këto rrethana kemi shprehur interes për marrjen në pronësi të një pjesë të Arkivit Vendor Shtetëror të Qarkut Dibër të një sipërfaqje ndërtimi prej 300 m² ku sipërfaqe shfrytëzimi është 241 m², në katin e parë. Kjo sipërfaqe do lironte ambjentet (zyrat) që janë zënë me dokumentacion arkivor ku gjyqtarët dhe administrata gjyqësore do ishin në kushte normale pune. Gjithashtu do kishte kushte fizike për ruajtjen, sigurinë dhe administrimin optimal të njësive të ruajtjes të fondit arkivor tipologjik gjyqësor në përputhje me kërkesat bashkëkohore, por nga ana Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave kërkesa jonë u refuzua por kanë lejuar të përdorim një pjesë të Arkivit Vendor Shtetëror të Qarkut Dibër për një periudhë 2 vjeçare.

Gjatë vitit 2024 nga ana e këtij sektori janë përpunuar njësitë e ruajtjes arkivore (dosje gjyqësore) me afat ruajtje të përhershme (RHK) të ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër deri në vitin 1999 të cilat janë dërguar në Arkivin Shtetëror të Sistemit Gjyqësor Tiranë ndërsa për ish Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat kanë qenë dërguar njësitë e ruajtjes arkivore me afat ruajtje përgjithmonë (RHK) deri në vitin 2007. Gjithashtu, është bërë hartimi i listave të veçimit të njësive të ruajtjes të fondit të përkohshëm arkivor tipologjik gjyqësor të veçuar për asgjësim që ka humbur vlerën e ruajtjes për periudhën nga 1946 -1991 (gjithsej 7106 dosje). Për keto vite, ka aktualisht rreth 10 ml dokumentacion të pasistemuar.

Gjithashtu gjatë vitit 2024, është ngritur edhe Komisioni i Ekspertizës pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër. Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër për vitin 2024, për shkak të mungesës të specialistit të arkivit dhe volumit të madh të dokumentacionit arkivor nuk është bërë e mundur përpunimi dhe dorëzimi i dokumentave arkivor administrativ (RHK) që kanë më shumë se 25 vjet pranë fondkrijusit (Gjykatës). Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave i ka bërë me dije Gjykatës se duhet të marrë masa për përpunimin dhe dorëzimin e

dokumentave me rëndësi historike (RHK) mbi 25 vjet nga krijimi i tyre duke kërkuar edhe punonjës me kontratë jashtë organikës. Në këto kushte, do i kërkojmë KLGj-së për miratimin e të paktën një punonjësi arkivi me kontratë për një periudhë dy vjeçare, që të bëhet e mundur sa më shpejt përpunimi dhe dorëzimin i dokumentave (RHK) pranë DPA-së.

5. DISA KONKLUZIONE DHE KONSIDERATA PËRFUNDIMTARE

1. Evidentohet tendenca në rënie e numrit të çështjeve gjyqësore të regjistruara. Ndërkohë, për vitin 2024 ka më pak çështje të përfunduara se në vitin 2023. Ky element ka ndikuar që edhe numri i çështjeve të mbartura nga viti 2024 të jetë më i madh se vitet parardhëse. Kjo për shkak se në vitin 2024, ka pasur lëvizje në trupën gjyqësore duke sjellë vështirësi sa i takon ngarkesës në punë. Për rrjedhojë, ndarja e çështjeve në proces shqyrtimi nga këta gjyqtarë ishte një ngarkesë e shtuar për trupën gjyqësore. Për vitin 2025, do të jetë prioritet ulja e çështjeve të mbartura në mënyrë që të ulët numri i çështjeve për gjyqtar. Nëse gjykata do të funksionoj gjatë gjithë vitin me 7 gjyqtarë, është e mundshme që ky numër i çështjeve të mbartura të ulët ndjeshëm.
2. Pjesa më e madhe e gjykimeve janë zhvilluar brenda afateve orientuese për kohëzgjatjen shqyrtimit gjyqësor të rekomanduara nga CEPEJ. Rezulton se janë përmbushur plotësisht afatet e gjykimit të çështjeve sipas kategorisë më cilësore “A” të CEPEJ (Time Frames “A”). Faktorët që ndikojnë në shpejtësinë e gjykimit për vitin 2024 mund të klasifikohen si të jashtëm dhe si të brendshëm të tillë si: i.) sistemi i shërbimit postar të njoftimeve; ii.) mungesa e një sistemi të saktë adresash; iii.) mungesa e njohurive procedurale të punonjësve të postës që kryejnë njoftimet për llogari të Gjykatës; iv.) sjellja e palëve ndërgjyqëse si mosparaqitja e palëve në gjykim, paraqitja e kërkesave për shtyrje të seancës, nisur nga pjesëmarrja në gjykim tjetër, vështirësitë për t’u paraqitur; v.) vështirësia e palëve për të siguruar dhe paraqitur provat e caktuara të cilat ndodhen pranë institucioneve shtetërore, dhe në disa raste vetë këto institucione përmbushin me vonesë urdhërat e gjykatës; vi.) rritja e numrit dhe e llojit të veprimeve procedurale të gjyqtarit në zbatim të ndryshimeve ligjore.
3. Gjatë këtij viti, ka pasur përmirësim në ofrimin e shërbimeve mbështetëse. Megjithatë, vlerësohet emergjente shtimi i ambienteve, për arsye se organika e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ushtron funksionin në të njëjtin ambient të ish-Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, por me dyfishin e organikës së saj.
4. Vlerësohet emergjente për t’i kërkuar Këshillit të Lartë Gjyqësor për investime në infrastrukturë, në mënyrë që të krijohen ambiente të përshtatshme pune për gjyqtarët dhe stafin administrativ.
5. Në lidhje me veprimtarinë administrative vlerësohet se ka probleme në sistemimin e dokumentacionit arkivor. Vlerësohet e domosdoshme krijimi i hapësirave të reja duke u bërë i mundur transferimi i dosjeve arkivore në një ambient tjetër. Vazhdimin e procesit të përpunimit të dosjeve gjyqësore për ruajtje të përhershme/përkohshme dhe asgjësim.

6. Vlerësohet se duhet rritur bashkëpunimi me aktorët e tjerë, Prokurori, Polici, si dhe Institucione të tjera.

Në përfundim, shprehim falenderime për gjyqtarët, kancelarin, sekretarinë gjyqësore, si dhe gjithë stafin e gjykatës, të cilët me angazhimin e tyre kanë bërë të mundur përmbylljen e këtij viti me sukses pavarësisht sfidave të përditshme të punës.

Duke e konsideruar të përfunduar prezantimin e punës së gjykatës për vitin 2024, nëpërmjet kësaj analize të përmbledhur, dhe duke menduar se me ndryshmet e ligjeve që janë bërë kohët e fundit në sistemin gjyqësor, ku sistemi do të përballet me probleme të tjera, që do të dalin në praktikë si rezultat i implementimit të tyre, ju falenderoj për vëmëndjen që më kushtuat dhe ju uroj mbarësi për vitin në vazhdim.

Ju Faleminderit !

ZËVENDËSKRYETARI

- Romeo MERRUKO-